

Nr. 2501/002 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 28/01/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Komisionit Rregullator
Komisioni të Ankimimeve dhe
Sanksioneve

Lënda: REKOMANDIME – Lidhur me
amendimin e Vendimit Nr. 9 datë
24.12.2020 të Komisionit rregullator
“Për Rregullat e raportimit të
veprimtarive me karakter publik të
çdo institucioni publik, e me kapital
shtetëror, agjencive, enteve
shtetërore, kategoritë e veprimtarive
të ndaluara, si dhe monitorimin e
veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit
të burimeve njerëzore, financiare
dhe logjistike të administratës
shtetërore para zgjedhjeve” i
ndryshuar.”

I nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Anëtarë të Komisionit Rregullator!

Të nderuar Anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Në kuadër të bashkëpunimit me ju lidhur me konsultimin paraprak të projekt-akteve, për të cilin gjejmë rastin t’ju falënderojmë sërish,

Ju drejtohem me këtë shkresë për të shprehur opinionin tonë në lidhje me procesin e konsultimit publik të dy akteve nënligjore të cilat lidhen me amendimin e Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për Rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” i ndryshuar.”, opinion i cili është adresuar edhe më parë ndaj jush. (lutemi shihni emailin/Rekomandimin më të fundit të dërguar më datë 21.12.2024).

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me këtë amendim, janë dërguar tek aktorët e shoqërisë civile në datën 27 janar 2025, dy projektvendime për konsultim.

Konkretisht, në orën 16.42 projektvendimi “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”, projekt-akt i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

si dhe, në orën 17.52, projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, i ndryshuar, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, projekt-akt i dy Anëtarëve të Komisionit Rregullator.

Na lejoni të ri-sjellim në vëmendjen tuaj se KRIIK ka qenë një ndër aktorët që në vazhdimësi ka theksuar nevojën për amendimin e Vendimit nr. 9, qoftë kjo nëpërmjet kërkesave zyrtare dërguar pranë KQZ, qoftë në tryezat publike të zhvilluara për këtë çështje, apo edhe në takime jo publike.

Gjithashtu, KRIIK, si edhe aktorë të tjerë vendas apo ndërkombëtarë, e ka identifikuar problematikën që adreson ky Vendim si një nga problematikat kryesore të së paku dy proceseve të fundit zgjedhore dhe është investuar në vazhdimësi për adresimin e saj, si nëpërmjet raporteve e denoncimeve të dërguara lidhur me të, ashtu edhe me rekomandime konkrete për përmirësim të mekanizmit parandalues.

Konstatohet me shqetësim se, për sa është parë deri më tani, edhe në këto zgjedhje problematika mbetet mjaft e mprehtë.

Thënë sa më sipër, KRIIK gjykon se **iniciativa për përmirësimin e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, është tejet pozitive**, dhe në parim të dy projekt-aktet e përcjellë për konsultim sjellin amendime që kanë potencialin të përmirësojnë ndjeshëm kuadrin rregullator për parandalimin e përdorimit të burimeve shtetërore dhe autoritetit shtetëror për avantazh elektoral.

Në gjykimin e KRIIK, **të dy aktet e përcjellë plotësojnë njëri-tjetrin**, duke e vendosur theksin në elementë të ndryshëm, ndaj **do të ishte e udhës të paraqiteshin si një i vetëm, për të patur një projekt-akt sa më të unifikuar e më të plotë**. Ndërkohë që të tjerë elementë mund të shtohen ende në Vendim, që do ta adresonin problematikën në mënyrë akoma më të plotë.

Duke qenë se problematika që adreson ky vendim mbetet komplekse, KRIIK është i mendimit se **koha e vendosur në dispozicion për konsultim nga KQZ-ja është e pamjaftueshme** për një adresim të plotë e të duhur.

Referuar gjithë sa më sipër, si edhe faktit se afati ligjor i fillimit të implementimit të mekanizmit të raportimit e mbikëqyrjes ka filluar tashmë, gjykohet se **komponenti kohë në këtë fazë të procesit nuk duhet të jetë tejet shtrëngues**.

Në këto kushte, KRIIK Ju drejtohet juve **të Nderuar Anëtarë të Trupave Drejtuese të KQZ-së** që:

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Së pari, në frymën e bashkëpunimit për realizimin e amendimeve të një akti tejet të rëndësishëm për shkak të problematikës madhore që adreson, të **bashkërendoni hapat si organe të të njëjtit Institucion e të ndërveproni me njëri-tjetrin duke konkluduar në një akt të vetëm nënligjor**, i cili të përfshijë në përmbajtjen e tij të dy projekt-aktet e përcjella për konsultim, duke e amenduar apo edhe zëvendësuar tërësisht Vendimin nr. 9/2020.

Është e nevojshme që në këtë projek-akt të adresohen tërë problematikat dhe përvoja e përfituar nga zgjedhjet e 2021, 2022, 2023 dhe periudha parazgjedhore e deritanishme e zgjedhjeve të 11 majit 2025.

Po ashtu nevojitet që ky akt të përfshijë në përmbajtjen e tij nevojat për përmirësim e ndryshime të arsyetuara dhe konkluduara nga KAS në vendimmarrjen e tij përgjatë vitit 2022 dhe 2023.

Së dyti, pas konkludimit në një akt të vetëm, të **ndërmerrni në një afat kohor të arsyeshëm një konsultim të gjerë me të gjithë aktorët e interesuar, jo vetëm shkresërisht, por edhe nëpërmjet një tryeze diskutimi të hapur në ambientet e KQZ-së**.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto GOGO

Kryetar

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania